

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

Nr. 9531 Rep.

Nr. 3287 Kol.



**KONTRATË SHITJE KUOTE**

Në Tiranë, sot më 27/11 / 2018, para meje Julian Zhelegu, anëtar i Dhomës së Noterëve të Tiranës, me adrese ne rrugen “Pjeter Bogdani”, nr. 13, u paraqiten palët e kësaj Kontrate si më poshtë:

**SHITËSI:** z. **Ervin Celaj**, shtetas shqiptar, i biri i Gjergj, lindur me 27.11.1982 ne Lezhe, banues ne Tirane, mbajtes i leternjoftimit me nr. 032553963 dhe nr. personal F21127121R, madhor e me zotësi te plote juridike për te vepruar;

dhe

**BLERËSI:** z. **Donard Arapaj**, shtetas shqiptar, lindur me 08.10.1981 ne Tirane, mbajtes i leternjoftimit me nr. 030609481 dhe nr. personal I11008051C, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar.

**MEQENESE:**

- A. Shitësi zotëron 50% te Kapitalit te shoqerise “**Anchor Investments**” **Sh.P.K.**, një shoqëri e themeluar e qe funksionon sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, e regjistruar ne Regjistrin Tregtar Shqiptar me NIPT L71421016I, me seli ne adresen: Njesia Bashkiake nr. 1, Rruga “Themistokli Gërmenji”, Ambasador 1, Tirane (me poshte referuar “*Shoqeria*”);
- B. Shitesit deshiron t'i shese Bleresit dhe Bleresi deshiron te bleje nga Shitesit pjeset e kapitalit qe Shitesit zoteron ne kapitalin e Shoqerise se mesiperme, gjithsej 50% te Kapitalit te Shoqërisë;
- C. Në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe Ligjin Nr. 9901/2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, si dhe me vendimin bashkelidhur te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise, Palet vendosin te lidhin kete Kontrate.

**PER SA ME SIPER**, palët bien dakord si vijon:

1. Me nenshkrimin e kesaj Kontrate Shitesit i shet Bleresit dhe Bleresi blen nga Shitesit 50% (pesedhete perqind) te kapitalit te zoteruar ne kapitalin e shoqerise “Anchor Investments” Sh.p.k. Shitësi deklaron dhe garanton se ka marrë nga Blerësi, në mënyrë të plotë të gjithë çmimin e blerjes të rënë dakord prej 50.000 Leke (pesedhete mije leke) perpara nenshkrimit te kontrates dhe jashte zyres se noterise dhe për këtë arsye transferon në pronësi të Blerësi kuoten prej 50% te kapitalit te zoteruar prej Shitesit në Kapitalin e Shoqërisë. Shitesit deklaron dhe garanton se nuk ka asnje pretendim te cfaredolloji ne lidhje me pagimin e cmimit te shitjes dhe shprehimisht heq dore nga cdo pretendim i mundshem. Palet deklarojne e garantojne


reciprokisht njera-tjetren se cmimi i shitjes se kuotes eshte i drejte, i arsyeshem dhe i caktuar me vullnetin e lire e te plote te paleve.

2. Shitësit deklarojne dhe garantojne Blerësin se pjeset e kapitalit te trasferuara permjes kesaj kontrate, jane ne pronesine e tyre te plote e ligjore dhe te lira nga barra hipoteke apo pengje.
3. Me nenshkrimin e kesaj kontrate, Z. Donard Arapaj behet zoterues i 50 % te kapitalit te shoqerise dhe shitesi largohet nga shoqeria dhe humbet cilesine e ortakut te saj.
4. Blerësi pranon pronësinë mbi kuoten, duke njohur gjendjen e Shoqerise dhe bie dakord me të gjitha të drejtat dhe detyrimet e lindura nga zotërimi i kuotes brenda Shoqërisë, sipas përcaktimeve të Statutit të Shoqërisë dhe ligjit shqiptar.
5. Shitësi dhe Blerësi bien dakord të zbatojnë dhe të paraqesin që në kërkesën e parë të palës tjetër dhe/ose të Shoqërisë të gjitha dokumentet e nevojshme në mënyrë që të kryejnë të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e transferimit te Kuotes objekt të kësaj Marrëveshjeje, pranë Qendrës Kombëtare te Biznesit si dhe në çdo autoritet tjetër Shqiptar sipas përcaktimeve të Ligjit Shqiptar.


Kjo Kontrate u hartua në 4 (kater) kopje origjinale ne gjuhen Shqipe. Kontrata bazohet në nenin 705 të Kodit Civil (Shqiptar) dhe në Ligjin shqiptar "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Nr. 9901, date 14.04.2008. Marrëveshja u lexua përpara palëve, u gjend e rregullt, në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë dhe u nënshkrua rregullisht nga palët përpara meje Noterit dhe unë e vërtetoj atë në përputhje me ligjin.

#### PALET

**SHITESI**  
Ervin Celaj



**BLERESI**  
Donard Arapaj



**NOTER**  
JULIAN ZHELEGU

